LIGJ
Nr. 106/2018

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9573, DATË 3.7.2006, "PËR AUTORIPARIMIN, SHITBLERJEN, DEPOZITIMIN E MJETEVE RRUGORE ME MOTOR, TË RIMORKIOVE DHE PJESËVE TË TYRE TË DALA JASHTË PËRDORIMIT OSE TË BRAKTISURA DHE PËR VEPRIMTARITË QË LIDHEN ME TO", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9573, datë 3.7.2006, "Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2/1 hiqet numri 18.

Neni 2

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 21
Ushtrimi i veprimtarisë së një agjencie

1. Veprimtaritë e parashikuara në nenin 20, të këtij ligji, kryhen nga subjektet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
2. Kriteret për ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe numri i agjencive, për çdo qytet, përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon fushën e transportit, duke pasur parasysh numrin e mjeteve me motor të regjistruara.".

Neni 3

Neni 22 ndryshohet si më poshtë

"Neni 22
Njoftimi i agjencive

1. Subjektet, titullari i të cilave ka aftësitë profesionale, sipas neneve 23 e 29, të këtij ligji, ushtrojnë veprimtarinë e trajtimit të praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor.
2. Subjektet duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt të veprimtarisë së tyre trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor.".

Neni 4

Në nenin 29, pikat 1 e 4 ndryshohen si më poshtë:
"1. Ushtrimi i veprimtarisë së shitblerjes, të ndërmjetësimit, të autoriparimit për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot, të autorizuara nga prodhuesi i tyre, kryhet nga subjektet juridike, në përputhje

me dispozitat e këtij ligji, të cilat kanë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt të veprimtarisë së tyre, ushtrimin e këtyre veprimtarive.

4. Tarifat e dhënies së autorizimeve të përcaktuara në pikat 2 e 3, të këtij neni, miratohen nga ministri përgjegjës për financat.".

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.12.2018

Shpallur me dekretin nr.11048, datë 14.1.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta